



*Republika e Kosovës*  
*Republic of Kosova*



*Komuna Hani i Elezit*  
*Municipality of Hani Elezit*

## **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, vitin 2011, do ta vazhdojë me të njejtin organizim sektorial (urbanizmi, kadastrit, mbrojtja e mjedisit) dhe me të njejtin numër të zyrtarëve:

- Tre zyrtar Kadastral,
- Një zyrtar urbanizmi,
- Një inspektor ndërtimi dhe
- Një inspektor mjedisi.

-Buxheti i planifikuar i drejtorisë për vitin 2011 është:

-Paga dhe medetje .....	28350€
-Mallra dhe shërbime .....	5225€
<u>-Shpenzimet kapitale .....</u>	<u>384736€</u>
<b>-Gjithësejt buxheti</b>	<b>418311€</b>

### **Objektivat**

- Përmbyllja e hartimit të planeve zhvillimore komunale
- Përmirësimi i infrastrukturës në territorin e komunës
- Vënia nën kontrollë e ndërtimeve
- Mbrojtja e ambientit dhe instalimi stabilimenteve për përcaktimin e shkallës së ndotjes së ajrit në Han të Elezit

- Avancimi i sektorit të kadastrit, për shërbim cilësor dhe efikas të qytetarëve

## **SEKTORI I URBANIZMIT**

-Ky sektorë tërë aktivitetin e sajë në vitin 2011 do ta përqëndroj në:

1. Realizimin e plotë të projekteve investive të miratuara nga Kuvendi Komunal,
2. Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal si dhe hartimin e Planit Zhvillimor Urban,
3. Përgjigja në të gjitha llojet e kërkesave nga personat fizik dhe juridik,
4. Trajtimin dhe ndalimin e ndërtimeve ilegale,
5. Menaxhimin e pronës shoqërore,
6. Ndihmën e sektorit në menaxhim të shërbimeve publike etj.

### **1.PROJEKTET INVESTIVE**

-Puna jonë kryesore për vitin 2011, do të jetë në përgatitjen e dokumentacionit për projekte të ndryshme investive duke filluar nga përgatitja e projekteve ideore e gjerë në finalizimin e plotë të projektit (projekti zbatues), si dhe pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave, mbikqyrjen profesionale të punimeve gjatë realizimit të tyre si dhe pjesëmarrjen në procesin e vlerësimit dhe pranimit të punëve.

-Në këtë drejtim, dinamika e punës së këtij sektori do të ndikohet nga lista e projekteve investive për vitin 2011, të miratuara nga Kuvendi Komunal gjatë vitit të kaluar si dhe hartimi i projekteve të reja të cilat do të gjejnë zbatim në vitin 2011.

**Më poshtë po japim listën e projekteve kapitale investive për vitin 2011, të parapara dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal:**

1. Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit-Dimcë,
2. Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit-Varrezat e Dëshmorëve,
3. Instalimi i stacionit për monitorim të ajrit,
4. Punimi i nxemjes së sh.f. “Kështjella e Diturisë” në Paldenicë,
5. Rregullimi i rrugës Dheu i Bardhë-Paldenicë,
6. Rregullimi i sipërfaqes së tregut të gjelbërt,
7. Rregullimi i tensionit të lartë të rrymës nga rruga e Gorancës deri te ish repetitori i TVP-së,
8. Rregullimi i rrugës nga Ura e Fezës-Rrafshe-Meliq,
9. Rregullimi i rrugicave në disa pjesë të qytetit,
10. Aneksi i QKMF-së në Han të Elezit,
11. Ndërtimi i objektit të Qendrës për punë Sociale,

12. Renovimi i kulmit të shkollës fillore “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit,
13. Rihapja e rrugës Paldenicë-Neqafc,
14. Rregullimi i kanalizimit Uji i Thartë-Hani i Elezit,
15. Furnizimi me transformator të rrymës elektrike në lagjën Kallamoqe,
16. Rregullimi i rrugës dhe kanalizimit nga rruga e të Përndjekurve-Ura e Fejzës,
17. Renovimi i kulmit të shkollës së mesme “Dardania” në Han të Elezit,
18. Ndërimi i dysHEMEVE të klasëve të shkollës fillore “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit,
19. Ndriqimi i pjesëve të zonës urbane në Han të Elezit,
20. Dislokimi i trafos së qytetit,
21. Rregullimi i rrugës prej lagjës së Krasniqëve deri te sh.f. “Kështjella e Diturisë”.
22. Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e Re.

-Po ashtu, gjatë vitit 2011, drejtoria do të jetë e preokupuar me përfundimin e projekteve të pa përfunduara vitin e kaluar siq janë:

1. Përfundimi i asfaltimit të rrugës Hani i Elezit-Gorancë,
2. Përfundimi i asfaltimit të rrugës Hani i Elezit-Paldenicë,
3. Përfundimi i punimeve në rregullimin e hapësirave publike dhe
4. Ndërtimi i sallës së sporteve pranë sh.f. “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit.

## **2.MIRATIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR URBAN**

### **▪ Miratimi i planit zhvillimor Komunal**

Me mbështetjen teknike të Un-Habitatit, finansuar nga SIDA, ka përfunduar hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe nga data 17dhjetor PZHK, është në diskutim publik i cili do të zgjatë 60 ditë pra gjerë më 17.02.2011 viti. Pas kësaj plani do të dorëzohet MMPH-së, për verifikim dhe vlerësim se i njëjti plotëson të gjitha kërkesat e parapara me Ligjin e Planifikimit Hapësinor, dhe se është në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës. Miratimi i PZHK-së nga Kuvendi Komunal është i paraparë të bëhet në muajin Prill ose Maj të vitit 2011.

### **▪ Hartimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Urban**

Në Gusht të vitit 2010 ka filluar hartimi i planit Zhvillimor Urban i cili po ashtu është një obligim ligjor i Komunës. Hartimi i planit është i paraparë të përfundoj në Maj ose Qershor të vitit 2011, kur pritet dhe miratimi i sajë nga Kuvendi i Komunës. Edhe ky plan po hartohet nga Komuna me mbështetjen teknike të UN-HABITAT-it

### **3.PËRGJIGJJA NË TË GJITHA LLOJET E KËRKESAVE NGA PERSONAT FIZIK DHE JURIDIK**

-Në adresë të drejtorisë sonë vazhdimisht vijnë shumë lloje të kërkesave nga ana e qytetarëve dhe personave juridik siq janë: kërkesa për leje ndërtimi, leje të ndryshme shfrytëzimi, kërkesa për kyqje në rrjetin e ujësjellsit, kanalizimit etj.Drejtoria jonë është e gatshme që duke respektuar ligjet në fuqi ti përgjigjet në mënyrë efikase këtyre kërkesave dhe gjithmonë në bashkpunim të ngushtë me drejtoritë tjera si dhe stafin udhëheqës të Komunës.

### **4.TRAJTIMI DHE NDALIMI I NDËRTIMEVE ILEGALE**

-Të gjitha ndërtimet ilegale në Han të Elezit, do të trajtohen duke u bazuar në ligjet të cilat janë në fuqi si:

- Ligji mbi Ndërtimet 2004/15,
- Ligji për Planifikimin Hapsinor 2003/14,

Si dhe akteve të tjera nënligjore si dhe rregullativës Komunale e në radhë të parë Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban.Drejtoria e Urbanizmit është e vendosur në ndalimin e qfardo ndërtimi ilegal sidomos kur bëhet fjalë për pronën shoqërore.

### **5.MENAXHIMI I PRONËS SHOQËRORE**

-Pronat shoqërore të cilat tashmë janë në shfrytëzim e sipër do të menaxhohen nga sektori jonë.Banesat në pronësi shoqërore momentalisht janë të menaxhuara nga Agjensioni Kosovar i Pronës (KPA) dhe në rast të ndonjë ndryshimi na do të jemi të gatshëm që me punën tonë të ndihmojmë në zgjedhjen e këtij problemi.

### **6.MBROJTJA E MJEDISIT**

-Sektori i mbrojtjes së mjedisit për vitin 2011 ka planifikuar:

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, instalimin e stacionit monitorues të ndotjes së ajrit. Instalimi i stacionit do ti mundësoj drejtorisë formimin e qëndrimit adekuat dhe të argumentuar mbi nivelin e ndotjes së ajrit nga industritë ekzistuese e në veqanti nga “Sharr-Cemi”,
- Implementimin e plotë të ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit,
- Implementimin e plotë të rregullores Komunale mbi mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë këtu dhe hartimin e Strategjisë së veprimit në mjedis si dhe hartimin e planit vjetor të veprimit lokal në mjedis,
- Ndërmarrjen e masave parandaluese përmes inspektimeve të rregullta dhe aplikimit të masave ndëshkuese ndaj gjithë atyre që ndotin mjedisin,
- Bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor,
- Gjithashtu, vëmendje e veçantë do ti përkushtohet edhe organizimit të aksionit për shënimin e ditës ndërkombëtare të Tokës- 22 Prillit.

## **SEKTORI I KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

-Objektivat kryesorë të këtij sektori për vitin 2011, do të jenë:

- 1) Mirëmbajtja dhe azhurimi i operatit Kadastral,
- 2) Implementimi i Kadastrit digjital,
- 3) Implementimi i plotë i ligjit mbi themelimin e regjistrit të drejtës së pronës së paluajtshme,
- 4) Rregullimi i çështjeve pronësore juridike sipas dispozitave ligjore në fuqi,
- 5) Trajnime profesionale,
- 6) Mbështetja profesionale Kuvendit Komunal, AKP-së, KFOR-it, FSK-së etj.

-Objektivat e lartpërmendura do të realizohen përmes:

- ✚ Zbatimit të marrëveshjes së mirëkuptimit me GTZ-në Gjermane, për mbështetje të Komunës sonë, në ngritjen e kapaciteteve dhe performancës në fushën e kadastrit dhe gjeodezisë për periudhën kohore 2011-2013. Kjo mbështetje ka të bëjë me ndihmën materiale- furnizim të kadastrit me mjete pune dhe vegla të nevojshme kadastrale, si dhe ndihmë profesionale-një ekspert i GTZ-së do të qëndroj gjat tërë vitit 2011 në zyrat tona për të mbështetur profesionalisht zyrtarët tonë në ngritjen e performancës së përgjithshme. Qëllimi i këtij projekti është përafrimi i Kadastrit tonë, kushteve dhe standardeve të përcaktuara nga Banka Botrore dhe BE-ja.
- ✚ Dhe së dyti, Agjensioni Kosovar i Kadastrit, për vitin 2011 ka planifikuar instalimin e programit të ri të RDPP-së dhe Gjeomedisë i cili do të jetë unik për tërë teritorin e Kosovës. Ky program do të mundësoj mirëmbajtje dhe azhurim më të lehtë të operatit Kadastral si dhe ofrim të shërbimeve dhe produkteve Kadastrale më cilësore.